



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality

Kuvendi Komunal-Kamenicë
Datë: 04.02.2026

Bazuar në dispozitat e nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) dhe nenit 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28, datë 4 qershor 2008), si dhe Rregullores Sh.01.Nr.37866, të datës 05.12.2019, për Punën e Kuvendit të Komunës, si dhe në mbështetje të nenit 38 të Statutit Sh.01.Nr.20203, të datës 21.06.2023, të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës, në mbledhjen e mbajtur me datë 30.01.2026, miraton këtë:

V E N D I M

Për themelimin e Grupit Punues për hartimin e Draft Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Kamenicës për vitin 2026

1. **Miratohet** vendimi për themelimin e Grupit Punues për hartimin e Draft Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Kamenicës për vitin 2026.
2. Grupi Punues nga pika një (1) e këtij vendimi përbëhet nga këta anëtarë:
 - 2.1. **Arbnore Beqiraj Fera** - Kryesuese e Kuvendit Komunal;
 - 2.2. **Liridon Kastrati** - Këshilltar/e komunal/e nga Lëvizja Vetëvendosje (LVV);
 - 2.3. **Djellonë Rrudhani Ahmeti** - Këshilltar/e komunal/e nga Partia Socialdemokrate (PSD);
 - 2.4. **Labinot Skovrqani** - Këshilltar/e komunal/e nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK);
 - 2.5. **Jeton Biqkaj** - Këshilltar/e komunal/e nga Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK);
 - 2.6. **Granit Berisha** - Këshilltar/e komunal/e nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK);
 - 2.7. **Ivan Marcovic** - Këshilltar/e komunal/e nga Lista Serbe (LS);
 - 2.8. **Violeta Krasniqi** - Zyrtare e Kuvendit Komunal;
 - 2.9. **Lavdim Klaiqi** - Përfaqësues/e nga shoqëria civile.
3. Grupi Punues, në përputhje me pikën një (1) të këtij vendimi dhe në konsultim me Kryetarin e Komunës, drejtorët e drejtorive komunale, subjektet politike të përfaqësuara në Kuvend dhe përfaqësuesit e shoqërisë civile, harton draftin e Planit Vjetor të Punës së Kuvendit të Komunës së Kamenicës për vitin kalendarik 2026, të cilin e paraqet për shqyrtim dhe miratim në Kuvendin Komunal.
4. Plani Vjetor i Punës së Kuvendit duhet të përmbajë objektivat dhe qëllimet e Kuvendit, aktivitetet e planifikuara të Kuvendit dhe të komiteteve obligative dhe funksionale, afatet për

realizimin e aktiviteteve të parapara, si dhe koston financiare për zbatimin e Planit të Punës.

5. Plani Vjetor i Punës së Kuvendit mund të ndryshohet dhe plotësohet nga Kuvendi Komunal sa herë që paraqitet nevoja. Për zbatimin e këtij vendimi përgjegjës është Kryesuesja e Kuvendit Komunal të Kamenicës.
6. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryesuesja e Kuvendit Komunal.

Vendimi i u dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Shërbimit të Kuvendit, MAPL-së, Zyrës së Informimit, Zyrës së Përkthimeve dhe Arkivit.

Kryesuese e Kuvendit Komunal


Arbnore BEQIRAJ FERA





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi Komunal-Kamenicë
Më:04.02.2026

Bazuar në nenin 12, paragrafi 12.2, shkronja d), neni 17, paragrafi 1, shkronja b), neni 40 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale (Gazeta Zyrtare Nr. 28, publikuar më 4 qershor 2008), neni 53 paragrafi 1 dhe paragrafi 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.20/21, Qershor 2016), neni 12 paragrafi 2 të Rregullores (MAPL) Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimin e Akteve të Komunës, në mbështetje të nenit 5, paragrafi 1.2, nënparagrafi 1.2.1 dhe neni 6, paragrafi 1.2, nënparagrafi 1.2.1, lidhur me nenin 10, paragrafi 2, nënparagrafi 2.2, nenin 11 dhe nenin 15 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 30/2013), Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve Zhvillimore Komunale, Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 08/2017 mbi normat teknike të planifikimit hapësinor, Vendimin SP-02 Nr. 1129-3/25, datë 05.06.2025, nga MMPHI për dhënien e pëlqimit për "Planin Zhvillimor Komunal i Kamenicës 2025–2033", si dhe nenit 5, paragrafi 5.1, shkronja b), nenin 38, paragrafi 38.1 të Statutit 01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur me datë: 30.01.2026 miratoi këtë:

V E N D I M

Për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2025-2033

Neni 1

MIRATOHET "Plani Zhvillimor Komunal" për Komunën e Kamenicës për periudhën 8 (tetë) vjeçare 2025–2033" (në tekstin e mëtejme PZhK), si një dokument i planifikimit hapësinor multi-sektorial, i cili përcakton caqet afatgjata të zhvillimit ekonomik, social dhe hapësinor, duke përfshirë planin për zhvillimin e zonave urbane dhe rurale për tërë territorin e Komunës së Kamenicës, me sipërfaqe të përgjithshme prej ($S = 4,166,323.74 \text{ m}^2$), $S = 416.624 \text{ km}^2$.

Neni 2

- 2.1. "Plani Zhvillimor Komunal i Kamenicës 2025–2033" përcakton vizionin, parimet, objektivat dhe prioritetet e zhvillimit strategjik për tërë territorin e komunës, mbi të cilat bazohet hartimi i Hartës Zonale të Komunës së Kamenicës.
- 2.2. Pjesë përbërëse e këtij vendimi është "Plani Zhvillimor Komunal i Kamenicës 2025–2033" i hartuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor e Komunës së Kamenicës, duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 30/2023, dhe Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 11/2015 mbi elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve Zhvillimore Komunale, si dhe Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr. 08/2017 mbi normat teknike të planifikimit hapësinor,

dhe i miratuar me Vendimin SP-02 Nr. 1129-3/25, datë 05.06.2025, për dhënien e pëlqimit për “Planin Zhvillimor Komunal i Kamenicës 2025–2033” nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

- 2.3. “Plani Zhvillimor Komunal i Kamenicës 2025–2033” përmban pjesën tekstuale dhe pjesën hartografike, Raportin e Vlerësimit Strategjik Mjedisor dhe Raportin e Shqyrtimit Publik, të cilat janë pjesë përbërëse të këtij vendimi. Të gjitha këto janë të përkthyer në gjuhën serbe.

Neni 3

Të gjitha dokumentet tjera komunale të planifikimit hapësinor, që nuk janë në kundërshtim me “Planin Zhvillimor Komunal të Kamenicës 2025–2033”, mbesin në fuqi deri në miratimin e Hartës Zonale të Komunës së Kamenicës.

Neni 4

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen të gjitha organet e Komunës së Kamenicës, nën mbikëqyrjen e Kryetarit të Komunës.

Neni 5

Bashkëngjitur këtij vendimi është: Vendimi SP-02 Nr. 1129-3/25, datë 05.06.2025, nga MMPHI për dhënien e pëlqimit për “Planin Zhvillimor Komunal i Kamenicës 2025–2033”, Kërkesa Sh.02.Nr.15240, datë 19.06.2025 e parashtruar nga Drejtoria e Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, Vendimi Sh.01.Nr.21270, i datës 06.08.2025, i Kuvendit Komunal për Miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2025 – 2033, Akti i vlerësimit të ligjshmërisë, me Nr. Protokolli 5938-2/25, i datës 19.08.2025.

Neni 6

Pas miratimit nga ana e Kuvendit Komunal në Kamenicë, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040, nenit 8 lidhur me nenin 9 të Rregullores Nr. 10/2019 për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunave, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose në web-faqen zyrtare të komunës.

Neni 7

Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, shfuqizohet Vendimi nr. protokolli Sh.01 Nr. 21270, datë 06.08.2025, për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2025 - 2033.

A r s y e t i m

Plani Zhvillimor Komunal i Kamenicës 2025–2033 është dokument strategjik i planifikimit hapësinor, i hartuar nga Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor e Komunës së Kamenicës, në përputhje me dispozitat e Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174, si dhe akteve nënligjore përkatëse. I njëjti ka kaluar të gjitha fazat procedurale të parapara me ligj, përfshirë shqyrtimin publik, vlerësimin strategjik mjedisor dhe procedurat e konsultimit institucional.

Me Vendimin Sh.01.Nr.21270, datë 06.08.2025, Kuvendi Komunal i Kamenicës ka miratuar Planin Zhvillimor Komunal 2025–2033. Ligjshmëria e këtij vendimi është konfirmuar nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPHI), si autoritet mbikëqyrës për planifikimin hapësinor.

Provë: Akti i vlerësimit të ligjshmërisë, me Nr. Protokolli 5938-2/25, i datës 19.08.2025.

Megjithatë, pas miratimit të këtij vendimi, Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit (APK), me Vendimin Nr. 2190/25, datë 10.11.2025, ka konstatuar ekzistimin e konfliktit të interesit të një anëtarit të Kuvendit Komunal, i cili ka marrë pjesë në procesin e votimit të Planit Zhvillimor Komunal 2025–2033. Në këtë kontekst, APK ka kërkuar që Planin të rikthehet në procedurë votimi, për të eliminuar pasojat procedurale të konfliktit të interesit dhe për të garantuar standardet e transparencës, paanshmërisë dhe integritetit institucional në procesin vendimmarrës.

Provë: Vendimi me Nr. Protokolli 2190/25, i datës 10.11.2025.

Edhe pse vendimi paraparak i Kuvendit Komunal ka qenë ligjërisht i vlefshëm dhe i konfirmuar nga autoriteti kompetent, Kuvendi Komunal i Kamenicës, duke vepruar në frymën e ligjshmërisë, transparencës, përgjegjshmërisë dhe sigurisë juridike, ka vendosur që Planin Zhvillimor Komunal 2025–2033 të rimiratohet, si masë parandaluese dhe korrigjuese, me qëllim të shmangies së çdo paqartësie procedurale dhe për forcimin e besimit publik në proceset vendimmarrëse komunale.

Për këtë arsye, me këtë vendim:

- miratohet sërish Planin Zhvillimor Komunal i Kamenicës 2025–2033, dhe
- shfuqizohet Vendimi Sh.01.Nr.21270, datë 06.08.2025, për miratimin e Planit Zhvillimor Komunal 2025–2033,

duke siguruar vazhdimësi juridike, qartësi procedurale dhe zbatim të plotë të kërkesave institucionale, pa cenuar përmbajtjen substanciale të planit dhe pa krijuar pasoja negative në sistemin e planifikimit hapësinor të Komunës së Kamenicës.

Planin i rimiratuar me këtë vendim është i njëjti Plan Zhvillimor Komunal i miratuar më parë me Vendimin Sh.01.Nr.21270, i datës 06.08.2025 vetëm se rimiratohet në përputhje me kërkesat e Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit, duke eliminuar çdo dyshim procedural dhe duke garantuar integritetin dhe paanshmërinë në procesin vendimmarrës.

Me sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Shërbimit të Kuvendit, MAPL-së, Zyrës së Përkthimeve, Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor dhe QSHQ- arkivit.

Kryesuese e Kuvendit Komunal

Arbnore BEQIRAJ FERA





Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Komuna e Kamenicës
Opština Kamenica
Kamenica Municipality



Kuvendi Komunal-Kamenicë
Më: 04.02.2026

Bazuar në nenin 12 paragrafi 2 shkronja d) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 28/12, qershor 2008), neni 53 paragrafi 1 dhe paragrafi 3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr.20/21, Qershor 2016); neni 12 paragrafi 2 të Rregullores (MAPL) Nr.02/2021 për Procedurën e Hartimit dhe Publikimit të Akteve të Komunës, nenit 3, paragrafi 3.7, nenit 5, paragrafi 5.1, shkronja h), nenit 38, paragrafi 38.1 dhe neni 82 të Statutit Sh.01.Nr.20203 të datës 21.06.2023 të Komunës së Kamenicës, duke siguruar zbatimin e plotë të kërkesave institucionale, konkretisht Kërkesës për rishqyrtim Nr. 020-233/14, të datës 14.01.2026, të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për rishqyrtimin e Vendimit Sh.01 Nr. 21283, të datës 06.08.2025, të Kuvendit të Komunës së Kamenicës për caktimin e lokacionit për vendosjen e trafos elektrike, Kuvendi i Komunës së Kamenicës në mbledhjen e mbajtur me datë: 30.01.2026 miratoi këtë:

V E N D I M

Për rishqyrtimin e Vendimit Sh.01.Nr. 21283 për caktimin e lokacionit për vendosjen e trafos elektrike

1. Miratohet rishqyrtimi i Vendimi Sh.01.Nr. 21283, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Kamenicës me datë 06.08.2025, për caktimin e lokacionit për vendosjen e trafos elektrike.
2. Me këtë vendim, **SHFUQIZOHET** pjesërisht Vendimi Sh.01 Nr. 21283, në pjesën që i referohet Ligjit Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës, për shkak të mos zhvillimit të procedurës së paraparë sipas këtij ligji.
3. **MIRATOHET** caktimi i lokacionit për vendosjen e trafos elektrike në pjesën e parcelës kadastrale sipas certifikatës së pronësisë Nr. P-71107063-00977-1, në zonën kadastrale Poliçkë, në pronësi të Komunës së Kamenicës.
4. Nga sipërfaqja e përgjithshme e parcelës së cekur në nenin 3 të këtij vendimi, përcaktohet një sipërfaqe prej 9 m² për vendosjen e trafos elektrike, vetëm si përcaktim teknik dhe lokacional, pa krijuar të drejtë shfrytëzimi, posedimi apo ndonjë të drejtë tjetër reale mbi pronën komunale.
5. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë.
6. Bashkëngjitur këtij vendimi janë: Vendimi Sh.01 Nr. 21283, i datës 06.08.2025, i Kuvendit Komunal, Kërkesa për rishqyrtim Nr. 020-233/14, e datës 14.01.2026, e Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, për rishqyrtimin e Vendimit Sh.01 Nr. 21283, të datës 06.08.2025, të Kuvendit të Komunës së Kamenicës për caktimin e lokacionit për vendosjen e trafos elektrike, Pëlqimi Elektroenergjetik Nr. 1969, i datës 19.02.2025, i lëshuar nga KEDS –

Njësia e Shërbimeve me Konsumatorë, Zgjidhja Teknike Nr. 1969, e datës 19.02.2025, nga KEDS – Njësia e Shërbimeve me Konsumatorë, së bashku me skicat përkatëse, si dhe Letër-Informata Sh.07 Nr. 4571, e datës 25.02.2025, e Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor.

7. Pas miratimit nga ana e Kuvendit Komunal në Kamenicë, ky vendim hyn në fuqi 30 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr. 03/L-040, nenit 8 lidhur me nenin 9 të Rregullores Nr. 10/2019 për procedurat e hartimit dhe publikimit të akteve të Komunave, dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose në web-faqen zyrtare të komunës.

A r s y e t i m

Komuna e Kamenicës, në përputhje me **Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale**, konkretisht nenin 5, shkronja b), nenin 14, paragrafi 14.1 dhe nenin 17, shkronja f), si dhe në bazë të **Statutit të Komunës së Kamenicës**, neni 3, paragrafi 3.7 dhe neni 5, paragrafi 5.1, shkronjat f) dhe h), ka kompetencë të plotë për të poseduar, menaxhuar dhe administruar pasurinë komunale, si dhe për të ofruar dhe mirëmbajtur infrastrukturë dhe shërbime publike në interes të qytetarëve.

Si rezultat i ushtrimit të kompetencave vetanake të komunës, caktimi i lokacionit për vendosjen e trafos elektrike shërben për përmirësimin e infrastrukturës energjetike dhe ofrimin e shërbimeve publike.

Vendimi Sh.01 Nr. 21283, i datës 06.08.2025, është rishqyrtuar me kërkesë të **Ministrit të Administrimit të Pushtetit Lokal**, për shkak se në vendimin fillestar ishte përfshirë edhe **Ligji Nr. 06/L-092 për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës**, pa u zhvilluar procedura e veçantë e paraparë sipas këtij ligji.

Me këtë vendim për rishqyrtim, shfuqizohet pjesërisht vendimi i mëparshëm vetëm në pjesën që i referohet këtij ligji, ndërsa **miratohet caktimi i lokacionit dhe përcaktimi i sipërfaqes prej 9 m²**, ekskluzivisht si përcaktim teknik dhe lokacional, pa krijuar të drejtë shfrytëzimi apo ndonjë të drejtë tjetër reale mbi pronën komunale.

Ky rishqyrtim siguron zbatimin e kërkesës institucionale të MAPL-së dhe mbrojtjen e interesit publik të Komunës së Kamenicës.

Vendimi t'i dërgohet: Zyrës së Kryetarit, Zyrës së Informimit, Shërbimit të Kuvendit, Zyrës së Përthimeve, Drejtorisë për Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtorisë së Urbanizmit dhe Planifikimit Hapësinor, MAPL-së dhe QSHQ- arkivit.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal

